

MINISTRIA E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
MINISTARSTVO POLJOPRIVREDE, ŠUMARSTVA I RURALNOG RAZVOJA
MINISTRY OF AGRICULTURE, FORESTRY AND RURAL DEVELOPMENT
Arhivi Qendror - Centralno Arhiva - Central Archive

Nr./Br.No. 1337
Nr. i fq./Br. Str./No. pg. 2
Data/Datum/Date: 16.03.2020
PRISHTINE - PRISTINA - PRISTINA



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja
Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development

Kabineti i Ministrit / Kabinet Ministra / Cabinet of the Minister

Datë: 16.03.2020

Ref.KM 66/20

Në mbështetje të nenit 145 paragrafi 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke marr parasysh nenet 8, 9, 10 dhe 11 të Ligjit Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura (Gazeta Zyrtare, Nr. 7, 1 Mars 2019), nenin 78 paragrafi 3 lidhur me nenin 79 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare Nr.20/21, Qershor 2016), nenin 8 (paragrafi 1.4), Shtojcën (11) të Rregullores Nr. 05/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Vendimin Nr.01/07, të dt. 11.03.2020, Vendimin Nr.01/09, të dt. 13.03.2020, dhe Vendimin 01/11, të dt.15.03.2020, të Qeverisë së Republikës së Kosovës, Ministri i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, nxjerr:

V E N D I M

1. Shtyhen përkohësisht afatet procedurale për zbatimin e Projekteve të Zhvillimit Rural të përcaktuara sipas Udhëzimit Administrativ (MBPZHR) - Nr.16/2019 për Masat dhe Kriteret e Përkrahjes për Zhvillim Rural për vitin 2019, të datës 21.05.2019.
2. Shtyrja e përkohshme e këtyre afateve nga paragrafi 1 i këtij vendimi bëhet me qëllim të mbrojtjes të të drejtave të fermerëve, pas marrjes së masave për parandalim të infeksionit Corona Virus COVID-19 nga Qeveria e Republikës së Kosovës.
3. Shtyrja nga pika 1 dhe 2 të këtij vendimi vlen nga dita e nxjerrjes së Vendimit nr.01/07, datë 11.03.2020 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, deri në marrjen e një vendimi tjetër.
4. Obligohen të gjithë zyrtarët e Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural për zbatimin e këtij vendimi.

5. Zyrtarët nga pika 4 e këtij vendimi, të cilët nuk e zbatojnë këtë vendim do të ndëshkohen në pajtim me legjislacionin në fuqi.

6. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.



Vendimi t'i dërgohet:

- *Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;*
- *Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë;*
- *Kabinetit të Ministrit;*
- *DF&SHP - Divizioni për Buxhet dhe Financa, dhe*
- *Arkivit.*